



UNOSEK/PR/12
E hënë, 7 gusht 2006

Beogradi e Prishtina e mbajtën takimin e gjashtë për decentralizimin

Vjenë – Delegacionet nga Beogradi dhe Prishtina, sot, e mbajtën takimin e radhës të negociatave të drejtpërdrejta për decentralizimin në Kosovë nën mbikëqyrjen e të dërguarit të posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm për procesin e statusit të ardhshëm të Kosovës, Martti Ahtisaari.

Takimi i kryesuar nga këshilltari i lartë i UNOSEK-ut, Bernhard Schlagheck, u përqëndrua në kompetencat e komunave, në veçanti përkitazi me kujdesin shëndetësor, arsimin, policinë dhe drejtësinë dhe bashkëpunimin ndërkufitar.

“Unë, mund të them se i kemi sqaruar gjërat edhe më shumë”, i tha z. Schlagheck gazetarëve pas përfundimit të takimit, duke shtuar më tej “me një masë keqardhjeje, të dy delegacionet, ai i Beogradit dhe ai i Prishtinës vetëm i kanë rikonfirmuar qëndrimet e tyre për një numër sferash. Sa i përket pengesave kryesore, nuk kemi bërë ndonjë progress të dukshëm.”

Sido që të jetë, “në sferën e policisë janë bërë disa lëvizje për t’i ngushtuar dallimet” dhe vazhdoi duke thënë, “dhe se të dyja palët kanë treguar gatishmëri për ta vazhduar punën me UNOSEK-un në mënyrë që të arrihet më shumë gjuhë e përbashkët për aspektet më të veçanta.”

Për këtë qëllim, z. Schlagheck tha se delegacionet e UNOSEK-ut do të udhëtojnë në Beograd dhe në Prishtinë së shpejti për t’i diskutuar më tej çështjet në fjalë. UNOSEK-u pret që delegacionet përkatëse të konsultohen me udhëheqjet politike me qëllim të përpunimit të propozimeve të tyre dhe që ta përgatisin terrenin për delegacionet e UNOSEK-ut.

Para takimit, i dërguari i posaçëm Martti Ahtisaari është takuar ndaras me të dyja delegacionet. Ai kërkoi nga palët që të jenë më fleksibile në qasjet e tyre: “këto biseda janë një sprovë për të dyja palët për të parë nëse ato e kanë me gjithë mend atë që e thonë”, ka nënvizuar ai.